



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 19

Datë: 26. 05. 2017, ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rustemi, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

2. Këshilli për informim publik:

-Shqyrtimi dhe miratimi i tingullit;

-Shqyrtimi dhe miratimi i sloganit;

-Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit;

3. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Po fillojmë me mbledhjen e 19-të. A ka dikush ndonjë propozim, pyetje...? Nëse jo, fillojmë menjëherë. Kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2.Këshilli për informim publik:

Shqyrtimi dhe miratimi i tingullit

Iir Gashi: Duke pas parasysh dhe kohën e shkurtër, emergjente në të cilën jemi, fillojmë me shqyrtimin dhe miratimin e tingullit... Ne në komision, dy të parat i trajtuam me vëmendje, se të tretin propozim, me disa rekomandime të cilat, ndërkohë i shqyrtojmë bashkë. Kështu që, ne të gjitha i trajtojmë me vëmendje por mendoj që për dy të parat, ne patëm vendime të prera se cila do të jetë si rekomandim për ju. E treta, mbetet në harmoni me kompaninë. E lamë edhe pakë në shijen e tyre rreth dizajnit, e të cilat do të komponohen ngjyrat se si do të duken, pak a shumë disa propozime.

Mendoj, tha z. Gashi që të mos humbim kohë, të fillojmë të dëgjojmë tingullin pastaj, t'i shohim slloganin dhe dizajnin.

Betim Gjoshi: Unë kam ardhur në përfundim kjo kolona zanore, nuk është më e përshtatshme sepse, ngjanë në marsh, edhe nuk është e përshtatshme për procesin, për zgjedhjet...Duhet me kanë pak me ritëm ma të butë...

Blerim Gjoci, përfaqësues i operatorit të IP:.. Secila prej tyre, ka me variu prej spotit. Scilit spot, kemi me ja përshtatë dinamikës së spotit, ka që kanë me qenë me aukostikë, d.mth, ndërrojnë instrumentet..., ndreqet gjithçka, përshtatet si motiv... Cili ju pëlqen juve me përdor si motiv, a ju pëlqej e para apo e dyta, e pastaj...Kompozitori, është Andin Ramobrava...

Bajrma Lajtifi: Sigurisht, do të pyes ndokush se në çka asocon muzika, cili është motivi...Nuk është e keqe...

Enis Halimi: Po, duhet me e ditë motivin..

Blerim Gjoci: Nëse më lejohet, e para që u dëgjua këtu, ka pak motive të Kosovës motive etnike, e dyta, ka motive neutrale, dyjat janë triumfaliste...

Iir Gashi: Këshilli, i ka pruar të dytat, edhe pse unë kam qenë për të dyten që u ndëgjua këtu, por na dërguan të dyjat për shkak se patëm mendime të ndryshme. Tani, vazhdojmë me slloganin... Në fakt, ne si këshill jemi pajtuar për të parën... Është e fundit, kjo që është... Ato

kanë qenë tri propozimet e kompanisë, ne erdhëm në përfundim që kjo e fundit është, pra “vota lidhet me vullnet...”.

Valdete Daka: “Vullneti yt – voto”, duket pa lidhje, nuk ka kuptim...”Sot vendos ti”, për mua është më e mira...

Ilir Gashi: Ne, pak a shumë si këshill, jemi pajtuar për të fundit...

Adnan Rrustemi: Padyshim “Sot vendos ti”, është më e mira, po nuk kalon kjo... Praktikisht është më i miri, por “Vota jote - vullneti yt”, ishte pajtimi i këshillit, por me vlerësimin profesional të kompanisë, gjatë gjithë mesazhit të tërthortë që jepet me tekst dhe vizualisht, ne praktikisht, ia bëjmë me dije, dhe e ftojmë qytetarin me votuar...

Gjithkund, i themi voto zgjedhjet... Ideja, është që me theksuar që “vetëm vullneti yt”, është ai...

Ilir Gashi: Të vazhdojmë me propozimin e këshillit...

Valdete Daka: Nuk e di, po nuk po duket si slogan...

Adnan Rrustemi: Këta, e kanë pasur “Vota jote – vendi yt”, po unë kam propozuar që kjo të shtohet me: “Vullneti yt...”. Janë ndërruar vendet...

Ercan Spat: Po, ne si komision e kemi propozuar, pse se votoni propozimin tonë...?

(Nuk ka më tej incizim – stenogram...)

P.s. Pas shyrtimeve të detajuara, anëtarët e KQZ-së, miratuan tingullin, sloganin dhe dizajnin.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
